



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 shkurt 2015
Nr. ref.:RK 766/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI122/14

Parashtrues

Adem Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Panelit për lirim me kusht, Plk. nr. 72/14,
të 19 qershorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Adem Berisha, nga fshati Grashticë, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Plk. nr. 72/14 (në tekstin e mëtejme: Paneli për lirim me kusht), të 19 qershorit 2014, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht për pjesën e mbetur të dënimit të tij me burg.
3. Vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 qershor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet *“t’i ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] paragrafi 1 dhe 2, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta)”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 gusht 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kyeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 29 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ai të dorëzojë vendimin e kontestuar në Gjykatë.
9. Më 9 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi vendimin e kërkuar në Gjykatë.
10. Më 25 shtator 2014, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës Panelit për lirim me kusht.
11. Më 2 tetor 2014, Paneli për lirim me kusht iu përgjigj kërkesës.
12. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 2 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 727/08) e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim.
14. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
15. Më 14 mars 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. nr. 459/2009) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
16. Më 22 mars 2013, parashtruesi i kërkesës filloi vuajtjen e dënimit në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë.
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për lirim me kusht te Paneli për lirim me kusht.
18. Më 19 qershor 2014, Paneli për lirim me kusht (Aktvendimi Plk. 72/14) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për lirim me kusht.
19. Në arsyetimin e tij, Paneli për lirim me kusht konstatoi:

“[...] Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lart, paneli ka gjetur se:

Lirimi për shkak të përfundimit të mbajtjes së dënimit është caktuar për 23.4.2015.

I dënuari ka shfaqur sjellje të mira dhe qëndrim korrekt gjatë vuajtjes së dënimit, ndërsa sa i përket veprës penale i njëjti ka deklaruar se vepra është kryer nga pakujdesia.

Mirëpo, edhe përkundër raporteve pozitive përkitazi me shkallën risocializimit, paneli vlerëson se ende nuk është arritur qëllimi [...] të sanksionit penal [...], për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua, mirëpo si rezultat i sjelljeve të mira paneli vendosi që kjo çështje mund të rishqyrtohet në tre (3) muaj .

Paneli me rastin e vendimit mori parasysh të gjitha kriteret për lirimin me kusht të përcaktuara në dispozitën e nenit 14 të Rregullores nr. 01/39. mbi Organizimin dhe funksionimin e Panelit për lirim me kusht.

Nga sa u tha më lart, me zbatimin e nenit 25 pika 1.2 e të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit gjyqësor të Kosovës. u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Panelit të lirimit me kusht *“[...] nuk i ka marrë për bazë raportet nga Q. K. të vlerësuara nga stafi profesionist, por e sjell një vendim të gabuar, ku përsëri e vlerëson gjendjen faktike ku gjykata [Gjykata e Qarkut në Prishtinë] njëherë ka vendos për këtë”.*
21. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendon që refuzimi i kërkesës së tij për lirim me kusht *“t’i ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe*

Instrumenteve Ndërkombëtare] paragrafi 1 dhe 2, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës”.

22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Aktvendimi i Panelit për lirim me kusht gjithashtu ka shkelur “Kodin Penal dhe të Procedurës Penale (neni 94 paragrafi 1) [...]”.
23. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata “të anulohet vendimi i PLK [Paneli për lirim me kusht] të 19 qershorit 2014 dhe rasti të kthehet në rivendosje, sa më parë dhe të vlerësohet gjendja faktike dhe arritje e shkallës së risocializimit të mbështetur në raportet e Q. K. Smrekonicë [Qendra Korrektuese] Smrekonicë. Dua të theksoj që Q. K. Smrekonicë takon Q. K. të tipit të hapur”.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion duke marrë parasysh se vendimet e Panelit për lirim me kusht janë përfundimtare dhe nuk i nënshtrohen ankesës, dhe as kontestit administrativ. Gjykata, gjithashtu vëren se Aktvendimi i Panelit për lirim me kusht i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 qershor 2014, dhe ai e kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 23 korrik 2014.
28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm dhe se kërkesa ishte parashtruar brenda afatit kohor prej katër muajsh.
29. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të merr parasysh nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Rregulli 36 i Rregullores së punës

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Parashtruesi i kërkesës, siç u cek më lart, e konteston Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht (Plk. nr. 72/14, të 19 qershorit 2014), duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, aplikimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe të së drejtës së tij për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër penale.
31. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Paneli për lirim me kusht e refuzoi kërkesën e tij për lirim me kusht, duke i ofruar atij *“arsyetim të pa qartë dhe tepër konfuz”*. Ai më tej pretendon se Paneli për lirim me kusht *“nuk i ka marrë për bazë raportet nga Q. K. të vlerësuara nga stafi profesionist, por e sjellë një vendim të gabuar [...]”*.
32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Paneli për lirim me kusht e arsyetoi Aktvendimin e tij lidhur me këto pretendime konkrete të parashtruesit të kërkesës duke konstatuar që *“[...] edhe përkundër raporteve pozitive përkritazi me shkallën risocializimit, paneli vlerëson se ende nuk është arritur qëllimi [...] të sanksionit penal të paraparë sipas dispozitës së nenit 41 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ngase qëllimi i dënimit nuk është vetëm rehabilitimi dhe risocializimi i personit të dënuar por edhe ndikimi në personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave të tilla apo të ngjashme penale për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua”*.
33. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet përgjigjes së Panelit për lirim me kusht, ku thuhet se *“pretendimi i të dënuarit për shkelje të Kushtetutës dhe ligjit nuk qëndron ngase si i tillë rasti [...] është trajtuar konform ligjit dhe standardeve profesionale, duke marrë parasysh qëllimin e ekzekutimit të sanksionit penal, siç parashihet në ligj dhe rregulla procedurale”*.
34. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
35. Gjykata Kushtetuese gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, kur është e aplikueshme, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*,

Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28, shih edhe rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. 70/11, *parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

36. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut të 10 korrikut 1991)
37. Gjykata konsideron se procedurat në Panelin për lirim me kusht kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituaniës*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
38. Gjykata rikujton se çështja e parashtruesit të kërkesës është e ngjashme me rastin Nr. KI90/13 (Shih, rastin KI90/13 parashtrues *Lumni Limaj*, rast i Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 24 marsit 2014). Në atë rast, parashtruesi kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për lirim me kusht, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për lirim me kusht. Kërkesa e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë ishte refuzuar si qartazi e pabazuar, pasi që Gjykata vlerësoi se kërkesa nuk ishte arsyetuar *prima facie* dhe se parashtruesi nuk e kishte dëshmuar mjaftueshëm pretendimin e tij.
39. Në rastin e tanishëm, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 48 të Ligjit.
40. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi si dhe pse vendimi i Panelit për lirim me kusht, me të cilin atij nuk i lejohej lirimi me kusht, përfshin shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale të garantuara me Kushtetutë, dhe ai nuk ka paraqitur dëshmi për ta arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.
41. Si përmbledhje, pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij janë të padëshmuara dhe të pavërtetuara, dhe si të tilla janë qartazi të pabazuara.
42. Për arsytet e cekura më lart, Gjykata konsideron që, në pajtim me rregullin 36 (2) d), kërkesa është e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani